

DISENJOT INDUSTRIALE

a) “Disenjo industriale” (në vijim “disenjo”), nënkupton karakteristikat e formës së jashtme të një produkti, në përgjithësi, aspekti ornamental ose estetik i një produkti, si një i tërë ose i pjesëve të tij, që i jep atij një pamje të veçantë dhe që nuk përjashtohet nga mbrojtja, sipas pikës 3 të këtij neni.

b) “Produkt” është çdo artikull, i prodhuar në mënyrë industriale apo artizanale, përfshirë ndër të tjera edhe pjesët, që synohen të bashkohen në një produkt kompleks, paketimin, paraqitjen estetike, simbolet grafike dhe printimet tipografike, por duke përjashtuar programet kompjuterike.

c) “Produkt kompleks” është një produkt, i cili është i përbërë nga komponentë të shumfishtë, që mund të zëvendësohen, duke lejuar shpërbërjen dhe riformimin e produktit.

ç) Disenjat industriale mund të jenë dydimensionale, tridimensionale ose kombinimi i tyre.

2. Për të fituar mbrojtje, një disenjo duhet të jetë e re dhe të ketë karakter individual. Një disenjo e ndërthurur ose e aplikuar në një produkt, që është pjesë përbërëse e një produkti kompleks, mund të vlerësohet e re dhe të ketë karakter individual në qoftë se:

a) Pjesa përbërëse, pasi ndërthuret me produktin kompleks, mbetet e dukshme gjatë përdorimit normal të këtij të fundit. “Përdorim normal” do të thotë përdorimi nga konsumatorët, përjashtuar mirëmbajtjen, shërbimet ose punët riparuese.

b) Në masën, që këto tipare të dukshme të pjesës përbërëse i përmbushin, në vetvete, kërkesat e risisë dhe karakterin individual.

3. E drejta për disenjo nuk fitohet në rast se tiparet e shfaqjes së jashtme të një produkti:

a) Diktohen vetëm nga funksionimi i tij teknik;

b) Duhet të riprodhohen domosdoshmërisht në formën dhe përmasat e tyre të sakta, për të bërë të mundur që produkti, me të cilin është ndërthurur disenjoja, ose tek i cili disenjoja është aplikuar, të jetë i lidhur mekanikisht apo i vendosur në, përreth apo përkundrejt një produkti tjetër, në mënyrë që secili produkt të mund të kryejë funksionin e vet.

4. E drejta për disenjo, mund të fitohet kur disenjoja i shërben qëllimit, për të lejuar bashkimin e shumfishtë ose lidhjen e produkteve, që alternohen në mënyrë të ndërsjellë në një sistem modular.

Data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e një disenjoje vlerësohet data kur DPPM-ja merr në dorëzim aplikimin, e cila përmban elementet e mëposhtme:

a) kërkesën për regjistrim;

b) identitetin e aplikuesit;

c) përfaqësimin e disenjos së përshtatshme për riprodhim;

ç) vërtetimin të pagesës së tarifës së depozitimit.

2. Dy ose më shumë disenjo mund të jenë objekt i të njëjtit aplikim, me kusht që ato t’i përkasin së njëjtës klasë, në përputhje me klasifikimin ndërkombëtar të Locarnos.

3. Aplikimi për regjistrimin e një disenjoje përmban edhe këto elemente:

a) emrin dhe adresën e aplikuesit;

- b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit, si dhe autorizimin e përfaqësimit;
- c) treguesin e produktit, në të cilin disenjoja është e përfshirë ose mbi të cilin do të aplikohet;
- ç) përshkrimin e disenjos;
- d) kopje të përfaqësimit të disenjos, në përputhje me kërkesat e rregullores përkatëse;
- dh) klasifikimin e produkteve, në të cilat disenjoja është e përfshirë ose mbi të cilat do të aplikohet, sipas klasifikimit të Locarnos;
- e) identitetin e krijuesit ose të krijuesve të disenjos dhe një deklaratë që autorizon aplikuesin ta regjistrojë disenjon kur aplikuesi nuk është krijuesi;
- ë) nënshkrimin e aplikuesit ose të përfaqësuesit të tij;
- f) kërkesa të tjera të përcaktuara në rregulloren përkatëse

4. Aplikimi për regjistrimin e një disenjoje, i depozituar pranë DPPM-së, mund të përmbajë një deklaratë, ku pretendohet për prioritet dhe të gëzojë një të drejtë prioriteti, kur ai është i njëjtë me një aplikim të mëparshëm e të rregullt kombëtar, të depozituar nga aplikanti ose zëvendësuesi i tij ligjor:

- a) në bazë të legjislacionit kombëtar të njërit prej shteteve anëtare të Konventës së Parisit;
- b) në bazë të legjislacionit kombëtar të njërit prej shteteve anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Aplikimi i depozituar pranë DPPM-së gëzon të drejtën e prioritetit nga data e depozitimit të aplikimit të mëparshëm, me kusht që kërkesa pranë DPPM-së të bëhet brenda një periudhe gjashtëmuajore nga data e depozitimit të këtij aplikimi. Aplikim i rregullt kombëtar quhet çdo aplikim, i cili ka plotësuar kërkesat e nevojshme, për të marrë një datë depozitimi, pavarësisht se çfarë ka ndodhur më vonë me të. E drejta e prioritetit, e fituar si më sipër, sjell pasojë, që data e prioritetit të quhet si datë depozitimi e disenjos së regjistruar pranë DPPM-së. 5. Paraqitja e aplikimit për regjistrimin e një disenjoje, si dhe të gjitha procedurat e tjera përcaktohen në rregulloren përkatëse, në zbatim të këtij ligji.

E drejta për prioritetet nga ekspozitat ndërkombëtare

1. Për regjistrimin e një disenjoje, paraqitësi i një aplikimi, që ka ekspozuar një produkt ose produkte me këtë disenjo në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare, e paraqet aplikimin brenda gjashtë muajve nga data, kur produkti ose produktet e ofruara me këtë disenjo u paraqitën për herë të parë në ekspozitë. Në këtë rast, ai ka të drejtë që nga ajo datë të kërkojë të njëjtën prioritet, në përputhje me pikën 4 të nenit 119 të këtij ligji. 2. Certifikata e lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të ekspozitës, e cila përmban datën e ekspozimit për herë të parë të disenjos, si dhe të dhëna për produktin ose produktet e ekspozuara, shërben si dëshmi për paraqitjen e ekspozitës së produktit ose të produkteve.

Ekzaminimi i arsyeve absolute për refuzim

1. DPPM-ja, brenda tre muajve nga data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e një disenjoje, ekzaminon nëse disenjoja, përveç përmbushjes së kërkesave formale, është në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

2. Nëse disenjoja nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit, DPPM-ja njofton aplikuesin dhe i jep atij mundësinë të parashtrojë, brenda dy muajve nga data e njoftimit, vërejtjet dhe shpjegimet e tij ose të depozitojë dokumente shtesë. 3. Aplikimi refuzohet nëse aplikuesi nuk parashtrohet vërejtjet e tij apo nuk depoziton dokumentet shtesë të kërkuara brenda afatit kohor ose nëse DPPM-ja vëren se aplikimi nuk është në përputhje me nenin 115 edhe pas përgjigjes së aplikuesit. Ky vendim i njoftohet aplikuesit. Vendimi për refuzimin e disenjos, bazuar mbi arsye absolute refuzimi, merret nga DPPM-ja vetëm pasi është marrë vendimi mbi kërkesat formale.

Publikimi i aplikimit

1. DPPM-ja publikon të dhënat e aplikimit në buletin e saj nëse është lëshuar dëshmia e depozitimit dhe disenjoja është në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

2. Të dhënat, që publikohen në buletin, përcaktohen në rregulloren përkatëse.

3. Nëse, së bashku me aplikimin, paraqitet një kërkesë për shtyrjen e publikimit të disenjos së regjistruar ose të disenjove, për një periudhë deri në 12 muaj pas datës së depozitimit të aplikimit, DPPM-ja publikon të dhënat për pronarin e disenjos së regjistruar dhe, pas përfundimit të periudhës, publikon disenjon e regjistruar, përveç rastit kur aplikimi është tërhequr përpara përfundimit të periudhës së shtyrjes.